LIGJ
Nr.10 069, datë 5.2.2009

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES KUADËR NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË PËR BASHKËPUNIMIN PËR ZHVILLIM"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për bashkëpunimin për zhvillim".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6068, datë 29.2.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE KUADËR
MBI BASHKËPUNIMIN PËR ZHVILLIM MIDIS KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË

Duke konsideruar që:

- të vetëdijshme për lidhjet ekzistuese të miqësisë, dy vendet kanë për qëllim të forcojnë këto marrëdhënie mbi bazën e barazisë dhe interesit reciprok, edhe nëpërmjet zgjerimit dhe intensifikimit të aktiviteteve të bashkëpunimit për zhvillim;
- të dyja qeveritë synojnë të realizojnë aktivitete bashkëpunimi sipas strategjive të zhvillimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe koherente me linjat e drejtimit dhe programin e Ministrinë e Punëve të Jashtme–Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillimit (në vijim Kooperacioni Italian),

duke konsideruar të gjitha këto, qeveritë bien dakord për sa vijon:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe kuadri i aplikimit të Marrëveshjes

1. Marrëveshja kuadër e bashkëpunimit (në vijim marrëveshja) tregon afatet dhe kushtet përmes së cilave qeveria italiane, nëpërmjet Kooperacionit Italian dhe enteve zbatuese të iniciativave të financuara nga kjo zyrë, zotohet të ndihmojë qeverinë shqiptare.
2. Marrëveshja do të gjejë zbatim në të gjitha aktivitetet mbështetëse të ofruara nga

Kooperacioni Italian, përfshirë këtu ato të rregulluara nga marrëveshjet e projekteve ose nga akte të tjera midis palëve, që kanë për qëllim të disiplinojnë projekte specifike, në tërësi ose pjesërisht.

Neni 2
Autoritetet kompetente

1. Me qëllim vënien në jetë të kësaj Marrëveshjeje dhe marrëveshjeve specifike të projekteve, Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë dhe Departamenti për Bashkërendimin e Strategjive dhe Koordinimin e Ndihmës së Huaj do të përfaqësojnë Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Ministria e Punëve të Jashtme–Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim (MPJ-DPBZH), edhe nëpërmjet Ambasadës Italiane në Tiranë dhe/ose zyrës për të cilën do të flitet në nenin 7, do të përfaqësojë Qeverinë e Republikës Italiane. Në vazhdim subjektet e lartpërmendura do të quhen së bashku "palë" ose në mënyrë të veçantë "pala".

Neni 3
Objektivat dhe parimet e përgjithshme të bashkëpunimit

1. Palët impenjohen të promovojnë, në kuadrin e legjislacioneve përkatëse të çdo vendi, programe dhe projekte të përbashkëta të bashkëpunimit për zhvillim.

2. Palët impenjohen të fokusojnë aktivitetin e bashkëpunimit për zhvillim në parimet e vendosura nga Deklarata e Parisit mbi efikasitetin e ndihmave dhe të ndërmarrin veprime mbi realizimin e parimeve të pronësisë, bashkërendimit, harmonizimit, administrimit të rezultateve dhe përgjegjësive reciproke.

KREU II
ZBATIMI I PROJEKTEVE

Neni 4
Mënyrat e identifikimit të programeve dhe projekteve

1. Iniciativat e Kooperacionit Italian nisin pas një kërkese me shkrim të paraqitur nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë. Kjo kërkesë bazohet në propozimin e bërë më parë në Ministrinë e Financave nga Departamenti për Bashkërendimin e Strategjive dhe Koordinimin e Ndihmës së Huaj. Kooperacioni Italian vlerëson çdo iniciativë në bazë të procedurave të veta dhe duke vlerësuar burimet financiare të disponueshme.

2. Çdo iniciativë uniformohet me linjat orientuese të vendosura në programin e vendit dhe protokollin e bashkëpunimit të miratuar midis palëve (në vijim i referuar si "Protokolli i bashkëpunimit"). Përkufizimi i protokollit të bashkëpunimit përfaqëson pikën e referimit për të identifikuar, përgatitur dhe vlerësuar çdo projekt për zhvillim.

3. Çdo projekt rregullohet sipas një marrëveshjeje specifike të projektit dhe, nëse është e nevojshme, nga një marrëveshje financiare, të cilat tregojnë me detaje të drejtat dhe detyrimet specifike të çdonjërit prej subjekteve të përfshira në zbatimin e këtij projekti.

4. Mënyrat e përzgjedhjes së furnizuesve të të mirave, shërbimeve dhe punimeve përcaktohen nga normat mbi prokurimin, të parashikuara nga Komisioni Europian për ndihmat në vendet e treta, përveç rasteve kur marrëveshja e projektit i parashikon shprehimisht ndryshe. Të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me projektin do të përcaktojnë shprehimisht ligjin e zbatueshëm.

Neni 5
Enti zbatues

1. Çdonjëra nga palët, në hapësirat respektive, mund të emërojë cilindo autoritet qeverisës ose cilëndo organizatë tjetër si enti zbatues përgjegjës për realizimin e iniciativave të bashkëpunimit, të përmendura në këtë Marrëveshje, sipas afateve dhe kushteve të vendosura mes vetë palëve.

2. Mund të marrë rolin e entit zbatues:

a) një institucion apo një organizatë joqeveritare italiane;

b) një institucion shqiptar;

c) një organizatë ndërkombëtare.

3. Enti zbatues zbaton projektin ose pjesë të tij sipas modaliteteve dhe termave specifikë që rregullohen në Marrëveshjen përkatëse të projektit, në kontrata, marrëveshje financiare ose në instrumente të tjera ekzekutive të besuara.

4. Nëse zbatimi i besohet direkt Kooperacionit Italian, referimet mbi entin zbatues që përfshihen në këtë Marrëveshje, duhet të nënkuptohen të referuara ndaj vetë Kooperacionit Italian, vetëm nëse nuk përcaktohet ndryshe në Marrëveshjen e projektit.

Neni 6
Format e bashkëpunimit

1. Kooperacioni italian mund të ofrojë bashkëpunim teknik, financiar, ndihmë humanitare ose ndihmë për emergjenca. Ndërhyrjet mund të jenë të kanalizuara në mënyrë dypalëshe ose në bashkëpunim me donatorë të tjerë apo organizata shumëpalëshe.

2. Instrumentet financiare të adaptuara nga Kooperacioni Italian për Zhvillim mund të jenë vijuese:

a) dhurata;

b) kredi ndihme;

c) kredi të kushtëzuara, në rastin e formimit të *joint ventures*.

3. Llojet e kontributeve financiare që mund të akordohen jashtë kuadrit të protokollit të bashkëpunimit janë vijueset:

a) ndihma emergjence;

b) kontribute për projekte të nxitura nga OJQ italiane dhe autoritetet lokale;

c) kontribute financiare për *joint-ventures*;

d) konvertim i huasë;

e) bursa studimi.

Neni 7
Bashkëpunimi i decentralizuar

1. Me bashkëpunim të decentralizuar do të kuptohet çdo lloj bashkëpunimi dhe veprimtarie ndërkombëtare e realizuar mes subjekteve territoriale italiane dhe shqiptare edhe me pjesëmarrjen e aktorëve përkatës të shoqërisë civile, duke pasur si objektiv fuqizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve, sipas politikave të jashtme të të dyjave qeverive.

2. Palët zotohen të favorizojnë bashkëpunimin e decentralizuar ndërmjet autoriteteve vendore në forma të ndryshme sipas dispozitave kushtetuese dhe legjislative përkatëse.

3. Palët janë të ndërgjegjshme që kjo formë e re bashkëpunimi, e karakterizuar nga një pjesëmarrje e gjerë popullore dhe nga të mira reciproke ka specifikën dhe vlerën e vet, në sektorë, si për shembull, lufta kundër urisë dhe varfërisë, përfshirja sociale, promovimi i proceseve të demokracisë pjesëmarrëse dhe mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm social, ekonomik dhe territorial.

4. Palët njohin të drejtën që pushteti vendor të nënshkruajë marrëveshje me entet homologe për aktivitete bashkëpunimi. Këto marrëveshje duhet të përcaktojnë objektivat dhe

sektorët e ndërhyrjes dhe mund të tregojnë parashikimet e impenjimeve financiare. Për të përfituar nga kjo Marrëveshje, aktet duhet t'u dërgohen për dijeni autoriteteve kombëtare kompetente sipas procedurave të parashikuara nga rregullat përkatëse të çdo vendi, dhe të bëjnë pjesë në programe dhe marrëveshje kuadër bashkëpunimi, për të cilat qeveritë përkatëse kanë rënë dakord.

5. Palët zotohen t'i orientojnë veprimtaritë e bashkëpunimit të decentralizuar, duke i futur ato në protokollin e bashkëpunimit ose në programe kuadër tripalëshe ose shumëpalëshe që parashikojnë linja dhe tregues të prioriteteve tematike dhe teritoriale, si dhe mënyrat e përshtatshme të bashkëfinancimit.

6. Me përjashtim të disa parashikimeve për të cilat palët bien dakord rast për rasti, veprimtaritë e bashkëpunimit të decentralizuar mund të parashikojnë:

a) dërgimin, nga ana e pushtetit vendor, të ekspertëve, konsulentëve dhe personelit teknik dhe/ose administrativ;

b) rekrutimin në vend të ekspertëve, konsulentëve dhe personelit mbështetës;

c) aktivitete të enteve publike ose private të bazuara në territor ose të lidhura me partnerë territorialë (universitete, dhoma tregtie, sindikata, institute, agjenci ndërmarrje, organizata joqeveritare);

d) dërgimin e të mirave materiale dhe blerjen e shërbimeve të nevojshme për realizimin e veprimtarive për të cilat është rënë dakord;

e) dhënien e bursave të studimit;

f) pjesëmarrje financiare në programe dhe projekte zhvillimi të organizmave ndërkombëtarë;

g) pjesëmarrje e pushtetit vendor, nëpërmjet teknikëve dhe funksionarëve të tyre, në misione të bashkëpunimit dypalësh ose tripalësh.

7. Për të verifikuar shkallën e aplikimit të këtij neni dhe për të gjetur instrumente të reja që mund të rrisin efikasitetin, vizibilitetin dhe impaktin e bashkëpunimit të decentralizuar, palët zotohen të krijojnë një komitetit të përbashkët të përbërë nga qeveritë kombëtare përkatëse dhe nga institucione vendore të të dy vendeve të interesuara për çështjen, i cili do të mblidhet çdo vit.

8. Palët zotohen të realizojnë në mënyrë periodike forume dhe takime direkte për formulimin e strategjive të përbashkëta dhe për të stimuluar krijimin e rrjeteve të enteve vendore.

9. Për iniciativat e bashkëpunimit të decentralizuar dhe për personelin që lidhet me to, aplikohen dispozitat për të cilat flitet në nenet 12 deri në 15 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 8
Klauzola antikorrupsion

1. Palët kanë një interes të përbashkët në luftën kundër korrupsionit, që dëmton qeverisjen e mirë dhe përdorimin korrekt të burimeve të nevojshme për zhvillimin dhe që për më tepër dëmton konkurrencën e drejtë dhe të hapur, bazuar mbi cilësinë dhe çmimet. Deklarojnë pra qëllimin për të bashkuar përpjekjet e tyre në luftën kundër korrupsionit dhe që, për pasojë, asnjë ofertë, dhuratë, pagesë apo përfitim o ndonjë lloji që do të përbënte një akt jo ligjor korrupsioni, nuk do të ndodhë apo kryhet si drejtpërdrejt, ashtu dhe jodrejtpërdrejt, me qëllim ekzekutimin, apo si shpërblim për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Çdo akt apo fakt që të çon në këtë lloj veprimi, përbën një element të mjaftueshëm për t'u tërhequr nga Marrëveshja ose për të ndërmarrë çdo masë tjetër korrigjuese të parashikuar nga legjislacioni i palëve.

Neni 9
Verifikime administrative kontabël

1. Qeveria e Republikës Italiane mund të kryejë pranë enteve zbatuese të gjitha rishikimet

e llogarive ose kontrollet administrative që i quan të nevojshme dhe që kanë të bëjnë me përdorimin e fondit italian në kuadër të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10
Konsultimet

1. Për të vlerësuar iniciativat në zbatim dhe për të planifikuar ato të ardhshmet, palët konsultohen në mënyrë të vazhdueshme dhe shkëmbejnë gjithë informacionin e nevojshëm për arritjen e qëllimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Palët takohen të paktën një herë në vit dhe çdo rast tjetër që njëra prej tyre e quan të nevojshme, për të verifikuar gjendjen e zbatimit të programeve të parashikuara në protokollin e bashkëpunimit, për të rënë dakord mbi prioritetet e përbashkëta dhe mbi parimet e bashkëpunimit, për të gjetur orientimet e duhura për realizimin e programeve dhe projekteve të ardhshme të bashkëpunimit për zhvillim. Në përfundim të çdo takimi përpilohet një procesverbal që nënshkruhet nga përfaqësuesit e palëve.

KREU III
LEHTËSIME PËR KRYERJEN E AKTIVITETEVE TË BASHKËPUNIMIT

Neni 11
Zyra e Kooperacionit

1. Qeveria e Republikës Italiane mund të krijojnë pranë Ambasadës Italiane në Tiranë një zyrë të Kooperacionit Italian me qëllim lehtësimin e komunikimit dhe koordinimit me autoritetet shqiptare për çështjet që janë objekt i kësaj Marrëveshjeje. Ambasada Italiane në Tiranë i bën të ditur autoriteteve shqiptare ngritjen e zyrës së Kooperacionit Italian.

2. Zyra e Kooperacionit Italian përbëhet nga personel i dërguar nga Ministria e Jashtme Italiane dhe nga personel i punësuar në vend.

3. Ambasada Italiane në Tiranë i bën të ditur Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë emrat e anëtarëve të Zyrës së Kooperacionit Italian, duke përcaktuar se për cilin prej tyre mund të aplikohet Konventa e Vjenës e vitit 1961 mbi marrëdhëniet diplomatike. Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë lëshon një kartë korresponduese, në të cilën tregohet qartë titulli “Punonjës i Zyrës së Kooperacionit Italian në Republikën e Shqipërisë”.

4. Në Zyrën e Kooperacionit Italian mund të veprojnë stazhierë që kryejnë veprimtari të shkurtra praktike trajnimi. Stazhierët nuk janë pjesë e personelit të Zyrës së Kooperacionit Italian. Ata rekrutohen mbi bazën e normativave italiane. Me kërkesë të ambasadës italiane në Tiranë, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, autoritetet kompetente shqiptare pajisin stazhierët me vizë dhe lejeqëndrimi për kohëzgjatjen e qëndrimit të tyre.

5.Pasuritë e tundshme dhe të patundshme të Zyrës së Kooperacionit Italian janë pronë e Qeverisë së Republikës Italiane dhe gëzojnë privilegjet, përjashtimet dhe imunitetet e parashikuara nga Konventa e Vjenës e vitit 1961 mbi marrëdhëniet diplomatike. Përdorimi i këtyre të mirave materiale, të tundshme ose të patundshme, për qëllimet e parashikuara nga kjo Marrëveshje, nuk mund të përbëjë shkak për përjashtimin nga privilegjet, përjashtimet dhe imunitetet e parashikuara nga Konventa e Vjenës e vitit 1961 mbi marrëdhëniet diplomatike.

Neni 12
Parashikime të përgjithshme lidhur me përjashtimin nga taksat fiskale dhe doganore

1. Në kuadrin e projekteve të përfshira në zbatimin e Marrëveshjes, pala shqiptare:

a) përjashton nga çdo detyrim doganor, taksë dhe tatim ose ndryshe të emëruar (duke

përfshirë TVSH) të gjitha të mirat, përfshirë pajisjet, materialet, punët dhe shërbimet e ofruara ose financuara si dhuratë nga Republika Italiane;

b) jep të gjitha lejet, autorizimet, licencat, aprovimet dhe çdo dokument të nevojshëm për importimin, qoftë ky përfundimtar ose i përkohshëm, dhe rieksportimin e pajisjeve dhe të mirave të nevojshme me qëllim realizimin e projekteve.

Neni 13

Kushtet që kanë të bëjnë me institucionet e huaja, organizatat joqeveritare dhe ndërmarrjet

1. Institucione ndërkombëtare, organizata joqeveritare, ndërmarrje apo çdo person tjetër juridik me nënshtetësi jo shqiptare mund të marrin pjesë në aktivitete të bashkëpunimit të financuar nga pala italiane dhe të zhvillojnë aktivitete në territorin e Republikës së Shqipërisë në kuadër të bashkëpunimit për zhvillim mes palëve.

2. Vetëm për aktivitetet e vëna në jetë në kuadrin e zbatimit të Marrëveshjes, subjektet e përmendura në pikën e mësipërme:

a) nuk konsiderohen përgjegjëse për mospërmbushjen e detyrimeve të tyre në rastet kur kjo mospërmbushje ndodh për shkak të urdhrave apo instruksioneve të lidhura me sigurinë, të dhëna nga Qeverinë e Republikës Italiane;

b) gëzojnë të drejtën të importojnë dhe rieksportojnë, të përjashtuar nga taksat doganore dhe çdo tatim i ngjashëm, aparaturat profesionale dhe të mirat e nevojshme me qëllim vazhdimësinë e detyrimeve të marra, apo të shesin /dhurojnë këto mjete në Republikën e Shqipërisë, kur të mos jenë më të nevojshme për arsye shërbimi pas shlyerjes së taksave doganore dhe tatimeve të ngjashme;

c) përjashtohen nga taksat dhe nga tatime të tjera të ngjashme mbi fitimet, mbi bazën e xhiros apo çdo bazë tjetër, si edhe mbi pagesat dhe shpërblimet që u paguhen atyre nga qeveria italiane për shërbimet e ofruara në kuadrin e programeve/projekteve të bashkëpunimit për zhvillim;

d) kanë të drejtë të hapin llogari bankare dhe të kryejë çdo lloj operacioni bankar për përmbushjen e detyrimeve që kanë marrë përsipër në kuadër të zbatimit të kësaj marrëveshjeje. Mbajtja në efikasitet e këtyre llogarive nuk do të pengohet nga kontrollet mbi shkëmbimet financiare të huaja apo detyrime të vëna në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Shumat në këto llogari janë lehtësisht të transferueshme në çfarëdo monedhe të konvertueshme;

e) përjashtohen gjithashtu nga çdo detyrim që ka të bëjë me regjistrimin në Republikën e Shqipërisë, për sa u përket autorizimeve profesionale, fiskale ose për çfarëdo arsye tjetër;

f) nuk janë të detyruar t'u japin asnjë informacion autoriteteve tatimore shqiptare, për aktivitete që bëjnë pjesë në kuadrin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje;

g) përjashtohen nga çdo lloj detyrimi ose tatimi në rastet kur në përfundim të projektit, siç është parashikuar në Marrëveshjen e projektit, do të duhet të transferojnë pronësinë e të mirave të tundshme, të patundshme dhe të regjistruara në emër të kundërpalës lokale ose mbi përfituesin final. Të gjitha detyrimet fiskale do të mbeten në ngarkim të përfituesit final.

Neni 14

Kushte që aplikohen për personelin e huaj

1. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë impenjohet të marrë të gjitha masat që mund të jenë të nevojshme me qëllim përjashtimin e qeverisë italiane, enteve të saj zbatuese, ekspertëve të saj dhe në përgjithësi gjithë personelit të huaj nga çdo rregullore ose akt normativ që mund të ndërhyjë në zhvillimin efikas të aktiviteteve të parashikuara në këtë Marrëveshje; gjithashtu impenjohet të garantojë çdo masë tjetër që mund të jetë e nevojshme me qëllim që të sigurojë shpejtësinë dhe efikasitetin e ndihmës italiane.

2. Kushtet vijuese do të aplikohen në Republikën e Shqipërisë ndaj personelit të huaj, jo

përfundimisht rezident në vend, duke përfshirë qytetarët shqiptarë, që:

a) janë të punësuar ose në shërbimin, kryejnë në Shqipëri aktivitete të lidhura me programet/projektet e bashkëpunimit për zhvillim, të financuara këto nga pala italiane, përfshirë vullnetarët, qofshin ata laikë ose fetarë, konsulentët dhe personelin jo shqiptar të punësuar në Zyrën e Kooperacionit për Zhvillim-njësia teknike lokale e ambasadës italiane në Tiranë;

b) qofshin të martuar, bashkëjetues, të varur nga subjektet që u përgjigjen pikave të lartpërmendura.

3. Pala shqiptare impenjohet t'i garantojë këtij personeli:

a) pajisje të shpejtë, të përjashtuar nga çdo detyrim, me viza me shumë hyrje dhe dalje për gjithë periudhën e aktivitetit të tyre në Republikën e Shqipërisë;

b) liri të plotë lëvizjeje brenda vendit dhe të drejtën e hyrje-daljes në masën e nevojshme për realizimin e programit/projektit ose për aktivitetet që kanë të bëjnë me Zyrën e Kooperacionit Italian;

c) pajisje të shpejtë me çdo leje apo licencë, si ndër të tjera, leje qëndrimi, leje pune, leje kërkimore dhe profesionale, përveç përjashtimit nga kushtëzimet mbi emigracionin dhe regjistrimin e të huajve për periudhën kur do të përfshihen në këtë Marrëveshje;

d) përjashtim nga tatimi mbi të ardhurat personale dhe nga çdo tatim tjetër që ka të bëjë me pagën që jepet nga qeveria italiane apo nga një punëdhënës, i cili duhet të furnizojë me të mira apo shërbime mbi bazën e një kontrate të nënshkruar drejtpërdrejtë, me Italinë ose me Shqipërinë, apo si nënkontraktues;

e) kushte të riatdhesimit, në rast krize kombëtare ose ndërkombëtare tërësisht të njëjta me ato të parashikuara për anëtarët e misioneve diplomatike;

f) të drejtë për të importuar ose rieksportuar të mira dhe pajisje profesionale të nevojshme për vazhdimin e misionit të tyre, duke përjashtuar nga detyrimet doganore dhe çdo detyrim tjetër fiskal.

4. Personelit që do të mbetet në shërbim për një periudhë më të gjatë se 6 (gjashtë) muaj duhet gjithashtu t'i garantohet:

a) e drejta për të hapur dhe vepruar në një llogari bankare në Republikën e Shqipërisë për nevojat e tij personale. Kjo llogari duhet të jetë e lirë dhe të mos i nënshtrohet asnjë kontrolli mbi kurset ose tatimet shqiptare, shuma gjithashtu duhet të jetë lehtësisht e transferueshme në çdo valutë të konvertueshme;

b) përjashtimi nga çdo detyrim doganor importimi ose eksportimi, tarifë doganore apo tjetër taksë, tatime, detyrime, barrë dhe çdo tarifë tjetër e ngjashme, përfshirë dhe TVSH mbi të mirat personale dhe shtëpiake, përfshirë, por jo kufizuar në, të mirat e lidhura me banesën, të mira personale dhe automjete. Këto të mira mund t'u shiten vetëm subjekteve që gëzojnë gjithashtu të drejtën e përjashtimit tatimor. Në rast të kundërt, të mirat e importuara duhet t'u nënshtrohen pagesave të taksave dhe tatimeve përkatëse.

5. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë mundet, me një akt të motivuar, të kërkojë largimin apo zëvendësimin e çdo anëtari të personelit, që është vënë në dispozicion nga Italia, shërbimi në punë apo sjellja e të cilit do të konsiderohet jo e kënaqshme. Italia mundet, në të njëjtën mënyrë, të kthejë në atdhe personelin në çdo moment.

6. Për sa nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Marrëveshje apo në marrëveshje të tjera të nënshkruara mes palëve, ato impenjohen të gjejnë një zgjidhje miqësore, duke pasur parasysh normativën përkatëse italiane dhe shqiptare në fjalë dhe me qëllim lehtësimin e aktiviteteve të bashkëpunimit.

Neni 15
Përgjegjësitë ndaj të tretëve

1. Pala shqiptare impenjohet të garantojë imunitetin e Kooperacionit Italianit për Zhvillim

dhe të enteve zbatuese në lidhje me veprimet ligjore të tentuara nga palë të treta në drejtim të tyre, apo kundër personelit në varësi të tyre, ose të subjekteve të tjera që veprojnë në emër dhe për llogari të tyre në ushtrimin e funksioneve të nevojshme për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

2. Kjo dispozitë nuk aplikohet në rastet kur veprimi ligjor rrjedh nga një veprim apo mosveprim i subjekteve të lartpërmendura i kualifikuar si i qëllimshëm, ose pasojë e një faji të rëndë.

KREU IV
DISPOZITA TË PËRKOHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 16
Ndryshime, interpretime dhe mosmarrëveshje

1. Çdo ndryshim i marrëveshjes në fjalë, duhet të bëhet me shkrim. Këto ndryshime hyjnë në fuqi ditën e parë të muajit që vjen pas atij në të cilin palët kanë njoftuar njëra-tjetrën për plotësimin e të gjitha procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi.

2. Çdo mosmarrëveshje për sa i përket aplikimit ose interpretimit të kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhet në rrugë diplomatike.

Neni 17
Hyrja në fuqi, tërheqja nga marrëveshja dhe kohëzgjatja

1. Marrëveshja do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që vjen pas atij në të cilin palët kanë njoftuar njëra-tjetrën për plotësimin e të gjitha procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi.

2. Secila nga palët mund të heqë dorë me shkrim nga Marrëveshja në çdo moment. Tërheqja do të ketë efekt duke filluar nga dita e parë e muajit të tretë pas lajmërimit, nëpërmjet kanaleve diplomatike, vullnetit për tërheqje. Në çdo rast dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mbeten tërësisht të aplikueshme për programet dhe projektet e nisura deri në momentin e lajmërimit për tërheqje ose të mosrinovimit.

3. Marrëveshja aplikohet në të gjitha projektet në zbatim dhe në proces programimi, datën e hyrjes në fuqi, përveç ndonjë parashikimi të ndryshëm në Marrëveshjen e projektit.

Në mirëbesim, personat e poshtëshënuar, të autorizuar si duhet nga qeveritë përkatëse, nënshkruajnë këtë Marrëveshje në emër të palëve.

Nënshkruar në Tiranë më 2 dhjetor 2008 në dy kopje origjinale, respektivisht në gjuhën shqipe dhe italiane, të dyja tekstet njësoj të vlefshme.

LIGJ
Nr.10 070, datë 5.2.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7703, DATË 11.5.1993 "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 10 paragrafi i parë shkronja “a” shifra “17,5” bëhet “13,8”.

Neni 2

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime:
a) Në pikën 1 bëhen ndryshimet si më poshtë:
i) në shkronjën “a” shifra “0,8” bëhet “0,3”;
ii) në shkronjën “b” shifra “2,3” bëhet “1,4”;
iii) në shkronjën “c” shifra “23,9” bëhet “21,6”.
b) Në pikën 2 bëhen ndryshimet e mëposhtme:
i) në shkronjën “a” shifra “0,5” bëhet “0,3”;
ii) në shkronjën “b” shifra “2,0” bëhet “0,9”.

Neni 3

Neni 79 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 79

Detyrimet e punëdhënësit dhe të të vetëpunësuarit

Punëdhënësi dhe i vetëpunësuari janë të detyruar:
a) të regjistrojnë në regjistrin vjetor të gjithë të punësuarit;
b) të njoftojnë në organet tatimore për ndryshimet dhe lëvizjen e punonjësve, sipas procedurave të përcaktuara me ligj;
c) të bëjnë sigurimin nga dita e parë, kur i punësuari fillon punë;
ç) të dorëzojnë në organet tatimore dokumentacionin, ku evidentohen paga dhe kontributi për çdo të punësuar, sipas formatit dhe afateve të përcaktuara me ligj.
Rregullat e lëvizjes së informacionit dhe të dokumentacionit ndërmjet punëdhënësit, strukturave tatimore dhe strukturave të sigurimeve shoqërore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 4

Neni 81 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 81
Regjistrimi

Personat juridikë, publikë, privatë dhe personat fizikë, që fillojnë veprimtari ekonomike për herë të parë, janë të detyruar të regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe në strukturat tatimore, sipas rregullave të përcaktuara me ligj. Regjistrimi i subjekteve, në bazë të të dhënave të sigurimeve shoqërore dhe mbyllja e veprimtarisë bëhen sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
Regjistrimi është akt administrativ, që nuk tregon detyrim për mbulimin me sigurime shoqërore.”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare

nga data 1.5.2009.

Shpallur me dekretin nr.6069, datë 20.2.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi